



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of
Kosovo

Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Financave- Ministarstvo za
Finansija- Ministry of Finance



Data: 17 Janar 2012

Komunikatë për shtyp,

Ministria e Financave dhe Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

Sot, Ministria e Financave e Republikës së Kosovës me sukses ka shitur në ankand konkurrues Bono Thesari 3-mujore të Republikës së Kosovës në vlerë prej 10,000,000.00 Euro. Bonot e Thesarit të cilat maturojnë me 18 Prill 2012 janë shitur me normë kthimi prej 3.5%. Ankandi kishte më shumë oferta se sa shuma e shpallur nga Ministria e Financave, respektivisht ofertimi arriti vlerën 22.5 milion Euro. Ministria e Financave pranoi oferta jo-konkurruese në vlerë prej 3.1 milion Euro.

Ankandi i sotëm ishte një ngjarje historike për Republikën e Kosovës. Ky ankand paraqet herën e parë të emetimit të Letrave me Vlerë të Qeverisë. Këto shuma do të përdoren për investime kapitale në buxhetin e shtetit.

Bankat Komerçiale kanë përdorur sistemin e ri të tregtimit elektronik për të paraqitur ofertat e tyre dhe ofertat e klientëve të tyre.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës e cila vepron si agjent fiskal për Ministrinë e Financave mbikëqyri ankandin e sotëm.

Ky ankand është i pari nga ankandet e planifikuara të Bonove të Thesarit përgjatë vitit 2012. Ministria e Financave do të lëshoj në total 74 milion Euro në Letra me Vlerë këtë vit.